



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 11.03.2014
Nr.0204-548

PËR: Sokol Bashota, Kryetar i Komunës së Klinës
Haxhi Ibishi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS Nr.06 -2033/2014 të pranuar më datën 07.04.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr.06 -2033/2014 të miratuar me datën 28.03.2014 nga Kuvendi i Komunës së Klinës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si vijon:

- Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës komunale në afat prej 40 vjeçar për ndërtimin e shtëpive të banimit për Komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas -RAE që rikthehen.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 11.03.2014
br.0204-548

Za: Sokol Bashota, Gradonačelnik opštine Klina
Haxhi Ibishi, Predsedavajući Skupštine opštine Klina

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke Skuptine opštine Klina br.06 -2033/2014 primljeno dana 07.04.2014

Poštovani ,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave na osnovu njenih nadležnosti i odgovornosti definisano članom 81.4 zakona o lokalnoj samoupravi , kao i uredbe br. 02/2011, o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva dodatak XII, nakon razmatranja odluke br.06 -2033/2014 odobreno dana 28.03.2014 od strane Skupštine opštine Klina , Potvrđuje zakonitost akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skadu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi

Odluka o davanju na dugoročno korišćenje opštinsko zemljište u roku od 40 godina za izgradnju kuća povratnicima zajednice Roma ,Aškalija i Egipćana -RAE.

Sa poštovanjem ,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a



Duke u mbështetur në nenin 14 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040 lidhur me nenin 40 pika 40.2 nën l), nenit 10 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhenje në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të komunës, nenit 20 paragrafi 3 pika 3.1 nën 3.1.3 si dhe paragrafit 5,6 dhe 7 të Rregullores QRK-Nr.23/2013 për Përcaktimin e procedurave të dhenjës në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtëshme të komunës, nenit 40 të Statutit të Komunës së Klinës si dhe duke iu referuar fillimisht Shkresës së Zyrës së Kryeministrit të RKS ref. 163/10 të datës 06.04.2010 pastaj Shkresës të QRKS-Ministrit për Komunitete dhe Kthim Nr.467 të datës 26.05.2011, Shkresës së parë të QRKS-Ministrit për Komunitete dhe Kthim Nr.1934 të datës 24.06.2013, pastaj Shkresës së QRKS-Ministrit për Komunitete dhe Kthim Nr.50 të datës 20.01.2014 si dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim të Komunës së Klinës Nr.01-950-4953/13 të datës 27.12.2013, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të, të rregullt për vitin 2014, të mbajtur më datën 28.03.2014, me 22 vota "Për", 2 vota "Kundër" dhe 1 votë "e përmbajtur", miratoi:

VENDIM

Për dhenjen në shfrytëzim afatgjatë të tokës komunale në afat 40 vjeçar për ndërtimin e shtëpive të banimit për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas-RAE, që rikthehen

I
1. MIRATOHET, kërkesa e QRKS-Ministrit për Komunitete dhe Kthim nr.467 e datës 26.05.2011, që ka të bëjë me ndarjen e tokës për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas-RAE për të kthyerit, pastaj kërkesa e parë e QRKS-Ministrit për Komunitete dhe Kthim Nr. 1934 e datës 24.06.2013 si dhe kërkesa e dytë e po të njëjtit organ Nr.50 e datës 20.01.2014 që të dyja me kërkesë për ndarje të tokës komunale në shfrytëzim për komunitetin RAE.

2. JEPET në shfrytëzim afatgjatë deri 40 vite toka komunale parcela kadastrale nr.633 në sipërfaqe prej 0.51,72 ha ZK. Klinavc e klasit të IV, me kulturë kullosë, në vendin e quajtur Arrishte. Toka në pronësi komunale e cekur në kuadër të kësaj pike jepet pa kompensim dhe me qëllimin e vendosjes dhe ndërtimit të shtëpive të banimit për komunitetin RAE që do të rikthehen dhe riatdhesohen nga Republika e Malit të Zi.

3. Specifikimi dhe skicimi i Planit realizues Urbanistik së bashku me Listën e familjeve përfituese, paraqesin numrin e sakt të trojeve ndërtimore dhe këto dokumente janë pjesë thelbësore e këtij vendimi duke përfshirë edhe Regjistrin e përbashkët të hartuar nga Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë si dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Klinë Nr.01-464-1862/2014 të datës 20.03.2014.

II

Afati i shfrytëzimit të tokës komunale sipas këtij vendimi fillon nga plotfuqishmëria e të njëjtit dhe mbaron me kalimin e 40 viteve nga dita e plotfuqishmërisë.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është fillimisht:

Shkresa e QRK-Zyrës së Kryeministrit, Ref. 163/10 e datës 06.04.2010 e posaçërisht Kërkesa e QRK-Ministrit për Komunitete dhe Kthim Nr.467 e datës 26.05.2011 si dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi është i tërë dokumentacioni zyrtar që është paraqitur në hyrje të këtij vendimi si dhe argumentet tjera të cekura në regjistrin e përbashkët të të dy Drejtorive përkatëse komunale Nr.01-464-1862/2014 i datës 20.03.2014.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është poashtu edhe i tërë dokumentacioni tjetër zyrtar financiar dhe urbanistik lidhur me implementimin e Projektit për Kthimin dhe riatdhesimin e komunitetit RAE nga Mali i Zi në Komunën e Klinës.

IV

Për implementimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës ndërsa që zbatimin e drejtpërdrejt të Projektit dhe realizimin e tij do të bëjë Kompania përfituese e ndërtimit së bashku me Drejtorinë e Urbanizmit, duke përcjell përveç tjerash edhe realizimin e donacionit të Qeverisë së Republikës së Malit të Zi që i dedikohet këtij projekti.

Mbi bazë të vendimit të miratuar pas plotëfuqishmerisë së tij në kuptim të nenit 20 paragrafi 8 dhe 9 të Rregullorës së QRK nr.23/2013, hartohet dhe nënshkruhet kontrata për dhenje në shfrytëzim afatëgjatë prona e palujtëshme e komunës e cila me përseafarmi përcakton kushtet-kriteret e shfrytëzimit të tokës komunale dhe e cila nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi i Institucionit Qëndror.

V

Më këtë vendim të njoftohen:

Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria për Komunitet dhe Kthim, Zyra komunale për Komunitet dhe Kthim, Drejtorja e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë në Klinë, MAPL- për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit, një kopje për tabelë të shpalljeve pas hyrjes në fuqi, Zyrën Ligjore, një kopje në web faqen e komunës si dhe një kopje Arkivit të Komunës së Klinës ndërsa një kopje e originalit të lendes gjendet tek Shërbimi për Punë të Kuvendit.

KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 06-253 2014
Klinë më dt. 07.04. 2014



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi

Arsyetimi

Kuvendi i Komunës së Klinës duke iu referuar obligimeve të shtetit të Kosovës përkatësisht Qeverisë së Republikës së Kosovës për plotësimin e kriterëve të përcaktuara nga BE –a, përveq tjerash muer parasysh edhe Standardin e BE-së, për Liberalizimin e vizave si dhe kushteve-kritetereve të tjera që duhet të i plotësojnë komunat e Kosovës si rrjedhojë e kësaj dhe në kuptim të dokumentit strategjik të quajtur Plani i veprimit për Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas-RAE në Komunën e Klinës 2014-2016 si dhe duke iu referuar edhe referencës së Qeverisë së RK-Zyrës së Kryeministrit Ref.163/10 të dt.06.04.2010, poashtu duke iu referuar edhe kërkesave të drejtëpërdrejta të QRK-së-Ministrisë për Komunitete dhe Kthim Nr.467 të dt.26.05.2011 pastaj Kërkesës së parë të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim Nr.1934 të dt.24.06.2013, Kërkesës së dytë poashtu nga Ministria për Komunitete dhe Kthim Nr.50 të dt.20.01.2014, duke përfshir edhe Kërkesën e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim Nr.11464-1651/2014 të dt.12.03.2014, së bashku më të gjitha argumentët që i ishin bashkangjitur kësaj po duke shqyrtuar edhe Evidencën-Regjistrin e dy drejtorive komunale lidhur më çështjen lëndore nr.01-464-1862/2014 të dt.20.03.2014, Kuvendi Komunal vendosi që të miratoji kërkesat e lartëcekura dhe të jap në shfrytëzim afatëgjatë tokën komunale për qellimin e ndërtimit të shtëpive të banimit për strehimin e familjeve të Komunitetit RAE, të cilët kanë shprehur vullnetin e rikthimit dhe riatëdhësimin.

Implementimin e këtij Projekti e ka inicuar Qeveria e Republikës së Kosovës dhe është përkrahur nga UNHCR-i si dhe Qeveria e Republikës së Malit të Zi.

Mbi bazë të të gjitha këtyre arsyeve të lartëcekura është vendosur si në vendimin lendor.